

ALARM 31

KEMI TË DREJTA. KËRKOJMË DREJTËSI!

10 dhjetor 2015 viti



MJAFTË MË ME RYSHFETET DHE BLERJEN E VOTAVE NË ZGJEDHJE.



Vota jonë vlen më shumë se një thes miell, para ose premtime të rrejshme për privilegje.

Fq. 6

MJAFTË NGUFASIN LIRINË E SHPREHJES! STOP PËR CENSURËN!

Fq.2

MJAFTË ME SHKELJEN E TË DREJTËS PËR PUNË DHE TË DREJTAT E PUNËTORËVE!



Pse prej viti në vit rritet numri i rasteve të vdekjes tek punëtorët? Pse për shumë punëtorë nuk ka të diel, ditë e lirë ose festë shtetërore? Pse shumë punëtorë/punëtore punojnë çdo ditë, të dielën, gjatë festave, më shumë se 12 orë në ditë?

Fq.7

STOP PËR PAGESËN E KUNDËRLIGJSHME TË TAKSËS RADIODIFUZIVE.

Fq.4

Të drejtat tona. Liritë tona. Gjithmonë.

Republika e Maqedonisë nëpunësve të lartë qeverishtë në krizë të thellë pasi itar dhe partiak. Bisedat keqpërdoret pushteti për qëllime personale dhe me këto shkelen të drejtat e njeriut. Sipas raportit më të ri të Komisionit Evropian, vendi është duke përjetuar “krizën më të vështirë politike prej vitit 2001”. Kriza thellohet pas shpalljes së bisedave të incizuara të

nëpunësve të lartë qeveritar dhe partiak. Bisedat tregojnë shkelje të të drejtave themelore, përzierje në pavarësinë gjyqësore, në lirinë e medieve dhe zgjedhjeve, dhe partizim e korrupsion në fusha të ndryshme. Në botë, 10 dhjetori shënohet si “Dita e të drejtave të njeriut”. Pikërisht për këtë shkak,

në këtë ditë përkujtojmë shkeljen e të drejtave tona nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë me moton “Të drejtat tona. Liritë tona. Gjithmonë”. Mjaftë më me shkeljen e drejtave tona! Kërkojmë që të drejtat të na respektohen dhe mbrohen!

PAPËRGJEGJËSIA E TYRE, SËMUNDJA JONË

„Qytetarët vite me radhë presin zgjidhjen e rasteve të tyre, për shkak të veprimit joefikas dhe jo në kohë sipas kërkesave të tyre nga ana e Fondit për Sigurim Shëndetësor dhe Ministria e Shëndetësisë.“ (Raport i Avokatit të popullit për vitin 2014)

Fq.8



Mjaftë na diskriminojnë!

Kushtetuta e RM



“Qytetarët janë të barabartë sipas Kushtetutës dhe ligjeve”

Kemi të drejtë për barazi. Të gjithë kemi të drejtën të gëzojmë të gjitha të drejta të njeriut. Askush nuk ka të drejtë të na diskriminon sipas asnjë baze.

Mjaftë me privilegjet partiake në administratë, shëndetësi, gjyqësor, tenderë, ndërtimtari!

Askush nuk ka të drejtë të punëson me librezë partiake.

Mjaftë me largimet nga puna për shkak të “papërshtatshmërisë partiake”.

Qeveria nuk ka të drejtë të kufizon të drejtat e grave. Kryeministri nuk duhet të nënçmon të drejtat e grave si “do drejta të grave”.

Mjaftë kufizoni të drejtën e grave për abort me ligje dhe kampanja diskriminatore.

Kërkojmë respektimin e rregullave për përfaqësim më të madh të grave në politikë.

Stop për diskriminimin etnik dhe racor të Romëve! Stop për segregimin etnik, veçanërisht në shkolla. Askush nuk duhet të nxit diskriminimin fetar. Personat me pengesa në zhvillim duhet të kenë qasje në të gjitha institucionet, shkollat, institucionet kulturore, institucionet shëndetësore dhe vendvotimet. Stop për mos dënimin e dhunës dhe diskriminimin e pakicave seksuale!

Kërkojmë Komision për mbrojtje nga diskriminimi që do të dënon edhe funksionarët qeveritarë që heqin të drejtat ose japin privilegje.

Shtet i cili diskriminon*

“Në komunën Shuto Orizari ende nuk ka gjinekolog që do mund të ofron shërbime gineko-akusherike për gratë dhe vajzat e komunës”. Romëve dhe shqiptarëve më shpesh nuk ju lejohet largim nga Republika e Maqedonisë dhe kthehen nga kalimet kufitare, me çka ju kufizohet e drejta e lëvizjes së lirë” (Raport i Avokatit të popullit për vitin 2014)

Injorojnë në çend që të mbrojnë

“...nga themelimi në janar 2011 deri në fund të 2014, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi ka pranuar vetëm 288 ankesa dhe ka vërtetuar se ka pasur diskriminim vetëm në 12 raste”. (Raport i Komisionit Evropian për 2015)

Mjaftë ngufasin lirinë e shprehjes! Stop për censurën!

Kemi të drejtën e lirisë së shprehjes dhe medie të lira dhe të pavarura.

Mjaftë më me mbylljen e medie dhe gazetarëve pasi kritikojnë qeverinë dhe partinë në pushtet.

Mjaftë më me fshehjen e informatave me karakter publik.

Përfaqësuesit e publikut dhe deputetët nuk duhet të hidhen jashtë seancës parlamentare si leckë!

Kërkojmë anulim të dënimeve drakonike për shpifje dhe fyerje të kritikuesve të qeverisë.

Mjaftë me rrahjet, frikësimet, kërcënimet dhe gjuhën e urrejtjes mbi gazetarët/et.

Gazetarët/et nuk duhet të rrihen nga policia ose ministra derisa kryejnë punën e tyre.

Gazetarët/et nuk duhet të burgosen për punën e tyre, dhe as të spiunohen, as të pengohen



me kordonë policor kur kanë protesta paqësore për lirinë e shprehjes.

Mjaft korrupsion të medie me anë të reklamave qeveritare.

Kërkojmë servis publik që nuk do të jetë në shërbim të partive.

Kërkojmë medie që nuk do të redaktohen nga funksionarë partiak ose shtetëror.

Kemi të drejtë për medie që nuk do të nxisin diskriminim dhe të folurit e urrejtjes, por do të luftojë kundër diskriminimit dhe të folurit e urrejtjes.

Kushtetuta e RM



“Garantohet e drejta e bindjes, vetëdijes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit. Garantohet liria e shprehjes, shfaqjes publike, informimit publik dhe themelimin e lirë të institucioneve për informim publik. Garantohet qasja e lirë ndaj informacioneve, liria e të pranuarit dhe transferimit të informacioneve”

Kërkojmë medie që nuk do të sulmojnë aktivistë/te qytetar, por do të bashkëpunojnë me ata për çështje të interesit publik.



I dënuar pa faj

“Tomislav Kezharovski nuk duhet të flejë asnjë ditë në burg. “Krimi” i vetëm i tij është që ka tregua për mangësitë e qeverisë maqedonase dhe gjyqësorit me anë të hulumtimeve të tij gazetareske”. “Ky spiunim i gazetarëve me të madhe, paraqet shkelje masive të lirisë së medie...” (Raportues pa kufi”)

Medie - kukulla

“...përzjerja e vazhdueshme në politikën redaktuese të medie, veçanërisht të televizioneve kombëtare dhe lidhjet e ngushta mes qeverisë dhe pronarëve të medie me publik më të madh që fitojnë pjesën më të madhe të të hollave të synuar për fushata qeveritare”. (Raport i Komisionit Evropian për 2015)

Nuk ka liri pa medie të lira

„...rrahja e gazetarit i cili mbulon protesta jo vetëm që është e paligjshme, por paraqet edhe sulm të pambrojtshëm mbi lirinë e medie” – Human Rights Watch, për rolin e policisë në shuarjen e protestave më 5 maj 2015

Liria në fund

Republika e Maqedonisë është në fund të listave për liri të medie. Maqedonia ka shënuar rënie në lirinë e medie nga vendi 34 (2009) në vendin 123 (2014), në Indeks të lirisë së shtypit të “Raportues pa kufi”.



Mjaft e pengojnë të drejtën për protestë të qetë!

Kushtetuta e RM



“Qytetarët kanë të drejtë të mbledhen në qetësi dhe shprehin protestë publike pa paralajmërim paraprak dhe pa licencë të posaçme. Përdorimi i kësaj të drejte mund të kufizohet vetëm në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme dhe lufte.”

Protesta e qeta në të cilat kërkohet përgjegjësi nga politikanët në pushtet janë e drejtë themelore e njeriut dhe demokratike. Shteti ka për obligim të mbrojë qytetarët që protestojnë në qetësi. Policia nuk duhet me dhunë të

hesht një protestë të lirë. Policia nuk duhet të përndjek ata që kanë qenë viktime të dhunës gjatë protestave dhe të dënojë me “qortim, bëritje dhe sjellje të pahijshme”.

Policia duhet të mundësojë dhe të mbrojë të drejtën e protestës së lirë, dhe jo të ndalojë me kordonë, bllokime ose me “kontrolle teknike”. Policia nuk duhet të kufizojë të drejtën e protestës me përdorim të forcës së tepruar, kur një pjesë e qytetarëve protestojnë dhunshëm.



Protesta është e drejtë demokratike

“Gjatë kohës së krizës politike në vitin 2015, shoqatat qytetare shpeshherë kanë luajtur rol konstruktiv duke organizuar proteste të shumta paqësore dhe mbietnike dhe duke kërkuar përgjegjësi më të madhe nga politikanët”. (Raport i Komisionit Evropian për 2015)

Mjaft përgjimit të paligjshëm!

Kushtetuta e RM



“Çdo qytetari i garantohet respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së jetës të tij personale dhe familjare, e dinjitetit dhe e autoritetit”

MPB-ja nuk duhet të ketë qasje të përhershme dhe të drejtë në gjitha komunikimet elektronike. Pajisja për përgjim është blerë me të hollat e tona dhe askush nuk duhet të keqpërdor kundër nesh. Pajisja në DSK nuk është synuar për përgjim të gazetareve, aktivistëve, politikanëve dhe mijëra qytetarëve.

Kërkojmë kuvendi të kontrollojë qeverinë dhe policinë sekrete, të mos keqpërdorin fuqinë kundër popullit.

Kërkojmë të hetohen gjitha keqpërdorimet të cilat tregojnë incizimet nga përgjimi masiv dhe i paligjshëm.

Kërkojmë gjithë funksionarët që kanë mundësuar ose bërë keqpërdorim me pajisjen për përgjim të dënohen para gjyqit dhe të ndëshkohen.

Kemi të drejtë privatësie kur komunikojmë. Sipas Kushtetutës, përgjimi i ligjshëm është i mundshëm vetëm në bazë të vendimit me gjyq.

Mjaft keqpërdorimit të policisë sekrete për qëllime partiake dhe personale.

Hetim duhet të ketë

[“Pohimet për keqpërdorim dhe shkelje që dalin nga komunikimet e kapura duhet të hetohen në tërësi. Autoritetet duhet të tregojnë vullnet të vërtetë politik që do të sigurojë pavarësi të plotë të sistemit gjyqësor, që nënkupton edhe të mundësojë Prokurorit Special të posa emëruar të punojë pa pengesa gjatë hetimit të incizimeve dhe përmbajtjen e tyre”. (Raport i Komisionit Evropian për 2015)]

Kush na garanton sigurinë?

“...policia jo vetëm që nuk ka arritur të plotësojë detyrat për mbrojtjen e sigurisë së protestuesve por ata në tentim të fshehin dështimin e tyre kërkojnë fajtorë në organizatorët”. (Raport i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM për protestën e studentëve më 28.03.2009 kundër ndërtimit të kishës në sheshin e Shkupit.)

Mjaft me polici dhe gjyqësor që nuk mbrojnë të drejtën e protestës së qetë!

Kërkojmë arma e policisë mos të jetë kërcënim për lirinë dhe protestë të lirë!

Kërkojmë gjithë policët dhe funksionarët që kanë penguar të drejtën për protestë të qetë të dënohen para gjyqit dhe të ndëshkohen.

Keqpërdorim i fuqisë

“Vëzhguesit e shoqërisë qytetare kanë njoftuar që policia ka përdorur forcë të tepruar për të rikthyer rendin publik dhe pas shpërndarjes së protestuesve, ka vazhduar të bëjë arrestime në lagjet përreth”. (Raport i Komisionit Evropian për 2015)





Mjaftë më me shkeljen e të drejtës së pronës!

Kushtetuta e RM



“Garantohet e drejta e pronës dhe e drejta e trashëgimit. Pronësia krijon të drejta dhe obligime dhe duhet të shërbejnë për të mirën e individit dhe komunitetit. Askujt nuk mund t’i merret ose t’i kufizohet e drejta e pronës dhe të drejtat që dalin nga ajo, përveç kur bëhet fjalë për interes publik i përcaktuar me ligj.”

Mjaft më nga pengesat burokratike, për shkak të cilave nuk mund të realizojmë apo të gëzojmë të drejtën tonë për pronë.

Mjaft më për pagesën e shpenzimeve për ri-regjistrim në kadastrë, gjegjësisht për gabimet e shkaktuara nga puna e saj joprofesionale dhe jocilësore.

Kërkojmë të ndalojnë pagesat e kundërligjshme dhe bllokimi i kundërligjshëm i llogarive nga përmbaruesit!

Pronësia e uzurpuar

“Agjencia e kadastrës së pasurisë së patundshme ... numër i madh i qytetarëve për shkaqe të panjohura i ka fshirë si pronarë në evidencën e kadastrës ose gjendjen e mëparshme e cila ka qenë e pakontestueshme mes palëve e ka ndryshuar. Me këtë procedurë disa qytetarë kanë mbetur pa të drejtën për pronësi, kurse tek të tjerët parcelat janë rritur, gjegjësisht zvogëluar dhe ekziston edhe mospërputhje e linjave kufitare të kadastrës nga vetë vendi dhe planet e parcelave të kadastrës.” – Avokati i popullit

Stop për pagesën e kundërligjshme të taksës radiodifuzive.

Pagesë e kundërligjshme

“Një numër i madh i qytetarëve, në mënyrë të pabazë dhe të kundërligjshme ngarkohet me pagimin e kësaj takse. Në numër të madh të rasteve i njëjti u arkëtohet me detyrim, borxhi i evidentuar pabazë nuk shlyhet, ndërsa mjetet e arkëtuara nuk kthehen, me çka shkelen të drejtat e qytetarëve.” – Avokati i popullit për taksën radiodifuzive

Përmbaruesit e injorojnë ligjin

Avokati i popullit konstaton që përmbaruesit nuk i respektojnë dispozitat ligjore në të cilat është paraparë përjashtim nga përmbarimi për mjetet e realizuara nga ndihma sociale, mbështetja ligjore ose papunësia e përkohshme dhe kufizimet, përmbarimi të kryhet më së shumti deri më 1/3 nga të ardhurat mujore nga rroga ose pension i atij që ka borxh.



Mjaftë na shkelin të drejtën e lirisë! Stop për torturën!

Kushtetuta e RM



“Liria e njeriut është pacenueshme”

Mjaftë me burgosjet politike dhe proceset gjyqësore politike!

Stop për vendimet kolektive për paraburgim dhe vendimet për paraburgim pa arsyetime përkatëse.

As kryeministri, as ministrat nuk duhet të paraqiten në rolin e prokurorëve dhe gjykatësve. Nuk duhet publikisht të dënohen persona pa mos pasur vërtetim të fajit me vendim gjyqësor fuqiptotë.

Kërkojmë që Avokati i popullit të heton dhe ndjek kryerësit e torturës, trajnimit jonjerëzor dhe dënimit.

Kërkojmë rol më aktiv të Avokatit të popullit si mekanizëm për parandalim të torturës.

Deri tani, Republika e Maqedonisë ka humbur më shumë raste në Gjykatën e Strazburit për shkak të mungesës së hetimit efikas, në raste ku policia ka përdorur forcë që rrezikon jetën.

Kërkojmë mekanizëm të pavarur për kontroll të policisë.

Drejtësia është e drejtë, jo privilegje!

Avokati i popullit: “Dua të ju informoj se personat e burgosur vazhdojnë të mos paraqesin torturën dhe veprimin jonjerëzor nga frika. Kjo dukuri shpjer në mosdënim dhe inkurajim të personave që torturojnë në llogari të parandalimit të torturës”.

Rojet e burgjeve jashtë kontrollit

“Informatat që i fitoi Mekanizmi shtetëror parandalues gjatë vizitës tregojnë që masat e ndërmarra nga SHNP Idrizovë nuk janë efektive sa duhet për parandalimin ose eliminimin e çfarëdo lloji rreziku nga tortura, trajtimi jonjerëzor dhe i vrazhdë”. (Raport i Avokatit të popullit për 2014)

Policia që rrezikon jeta

Në 2015 Gjykata Evropiane për të drejta të njeriut morri vendimin se përdorimi i forcës nga “Alfat” (gjuajtje rafalë kah automjetet) ka rrezikuar të drejtën e jetës së udhëtarëve.

Mjaftë na kërcënojmë dhe blejnë kur votojmë!

Kushtetuta e RM



“E drejta e zgjedhjes është e barabartë, e përgjithshme dhe e drejtpërdrejtë dhe realizohet në zgjedhje të lira me votim të fshehtë”.



Mjaftë më me rryshfjetet dhe blerjen e votave në zgjedhje.

Vota jonë vlen më shumë se një thes miell, para ose premtime të rrejshme për privilegje.

Mjaftë më me kërcënimet para dhe gjatë zgjedhjeve.

Stop me kërcënimet ndaj qytetarëve me largim nga puna ose “tërheqje të veshëve”.

Kërkojmë listë zgjedhore të pastruar dhe të saktë.

Mjaftë me keqpërdorimet e institucioneve shtetërore dhe parave tona në kampanjat parazgjedhore.

Kryeministri dhe ministrat nuk duhet të përdorin funksionin e vet për kampanjë partiake gjatë orarit të punës.

Manipulim i palejueshëm!

“Këto komunikime përfshinin diskutime për manipulim me listën zgjedhore, blerjen e votave, kërcënim i votuesve, përfshirë kërcënime ndaj nëpunësve publik dhe kompanie, dhe pengim i qytetarëve që mos të japin votën e tyre”. (Raport i Komisionit evropian për 2015)

MPB kurrë më nuk duhet të shndërrohet në shtab partiak!

Kërkojmë polici që do të mbrohet të drejtat tona zgjedhore, në vend që ti shkel.

Kërkojmë të dënohen “vagabondët më të mëdhenj në MPB” që janë kërcënuar gjithandej gjatë zgjedhjeve.


Kërkojmë të dënohen: të gjithë që kanë bërë ose fshehur krim gjatë zgjedhjeve; të gjithë që kanë manipuluar me listën zgjedhore; të gjithë që në mënyrë të paligjshme kanë nxjerr letërnjoftime ose pasaporta; të gjithë që kanë dhënë rryshfet ose kanë kërcënuar votuesit; të gjithë që kanë bërë shtypje dhe kërcënime ndaj nëpunësve shtetëror; të gjithë që kanë parandaluar qytetarët nga votimi.

Mjaftë më me heqjen e të drejtës për arsim!

Kushtetuta e RM



“Secili ka të drejtë në arsimim. Arsimimi është i arritshëm për secilin në kushte të barabarta.”
“Universitetit i garantohet autonomia”.



Mjaftë më me politikën kundër kushtetuese dhe reformat joprofesionale në arsim.

Stop për kërcënimet dhe shtypjet mbi studentët dhe nxënësit e shkollave të mesme që luftojnë për të drejtat e tyre.

Kërkojmë të ndërpritet me testimet ekstere joprofesionale në dëm të nxënësve.

Stop për kufizimin e autonomisë së universitetit.

Kërkojmë standard më të lartë për nxënësit dhe studentët, ushqim më të mirë, shkolla dhe fakultete më të mira, kushte më

Testimi ekstern në dëm të nxënësve

Avokati i popullit konsideron se testimi ekstrin i vendosur dhe realizuar në këtë mënyrë është në dëm të nxënësve”. (Raport i Avokatit të popullit për 2014)

të mira në konviktet e shkollave të mesme dhe universitare.

Kërkojmë arsimim cilësor që do të ndikon tek të rinjtë të mbesin në Maqedoni.

Mjaftë keni kufizuar të drejtën e lirisë për vendim mbi bërjen e fëmijëve!

Mjaftë më me politikanë që na përzien në të drejtën e lirisë për bërje të fëmijëve.

Politikat për nxitje të natalitetit nuk duhet të jenë diskriminuese. Kampanja “Secili duhet të ketë fëmijë të tretë” është ofenduese për ato që nuk munden ose nuk duan të kenë fëmijë.

Mjaftë më me kampanja të zeza kundër grave që duan të realizojnë të drejtën e tyre për ndërprerja të shtatzënisë.

Kërkojmë ndryshime të ligjeve kufizuese për ndalim të shtatzënisë që rrezikojnë të drejtat shëndetësore të grave.

Kushtetuta e RM



“Është e drejtë e njeriut që lirisht të vendosë për të pasur fëmijë”.

Kërkojmë zvogëlim të shpenzimeve të grave gjatë shtatzënisë dhe anulim të shpenzimeve për participim gjatë ndjekjes së shtatzënisë.



Statistika shqetësuese

“Shkalla e vdekshmërisë të foshnjave rritet në katër vitet e fundit” (Raport i Shoqatës së qytetarëve HERA).

Heshtja e të rinjve

“Avokati i popullit, apelon që nxënësit mos të pengohen në të drejtën e tyre për shprehje të qetë të pakënaqësisë, mbi njohuritë se nxënësit e të shkollave janë nën shtypje dhe kërcënime që mos të dalin në protesta mbi testimin ekstern...”, Njoftim, 2015

Mjaftë na rrezikojnë të drejtën e bashkimit!



Kushtetuta e RM



“Qytetarëve ju garantohet e drejta për bashkim për shkak të realizimit dhe mbrojtjes të së drejtave dhe bindjeve politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera”

Jemi të lirë të bashkohemi për shkak të realizimit dhe mbrojtjes të së drejtave dhe bindjeve tona. Jemi të lirë të themelojmë shoqata të qytetarëve dhe të partive politike.

Mjaftë na bëjnë shtypje të ju bashkëngjitëmi partive ose shoqatave dhe të largohemi prej tyre.

Stop për sulmet mbi shtabet partiake dhe arrestimin e funksionarëve partiak. Stop për shtypjet, ryshfetet, kërcënimet dhe shantazhet e funksionarëve të zgjedhur.

Mjaftë me shtypjet dhe gjuhën e urrejtjes ndaj shoqatave qytetare me qëndrim kritik.

Mjaftë me persekutimet dhe linçet publike të aktivistëve qytetarë dhe shoqatave që kritikojnë pushtetin.

Kërkojmë përfshirje më të madhe në krijimin e politikave dhe ligjeve.

Kërkojmë nga shteti të ndan më shumë mjete financiare për organizatat qytetare që merren me çështje të interesit publik.

Qytetare domethënë demokratike

“Shoqëria qytetare e përforcuar është komponentë kyçe për çdo sistem demokratik...” (Raport i Komisionit Evropian për 2015)

Kushtetuta e RM



“Secili ka të drejtë në punë, zgjedhje të lirë të punësimit, mbrojtje gjatë punës dhe në sigurim material gjatë kohës të papunësisë së përkohshme. Secili, në kushte të barabarta, e ka të arritshëm çdo vend pune. Secili i punësuar ka të drejtë në përfitim përkatës”

Mjaftë me shkeljen e të drejtës për punë dhe të drejtat e punëtorëve!

Pse prej viti në vit rritet numri i rasteve të vdekjes tek punëtorët? Pse për shumë punëtorë nuk ka të diel, ditë e lirë ose festë shtetërore? Pse shumë punëtorë/punëtore punojnë çdo ditë, të dielën, gjatë festave, më shumë se 12 orë në ditë?

Mjaftë më me shkeljen e Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës.

Pse shumë të punësuar nuk marrin paga në kohë? Pse, pesë vitet e fundit, rritja e shpenzimeve për jetë është shtatë herë më e madhe nga rritja e rrogës mesatare? Pse Maqedonia ka pabarazinë më

të madhe në shpërndarjen e të ardhurave krahasuar me vendet e rajonit?

Mjaftë më me pagat minimale që nuk i mbulojnë as mjetet e nevojshme për ushqim dhe pije për familje katëranëtarshë.

Mjaftë më me shtypjet mbi të punësuarit që e përdorin të drejtën e tyre për grevë.

Kërkojmë të ndalet punësimit me librezë partiake!

Kërkojmë rritje të rrogës minimale!



Mjaft më me shkeljen e të drejtës për mbrojtje shëndetësore!

Mjaft më nga pengesat burokratike të cilat pengojnë që të mjekohemi në kohë.

Kemi të drejtë për qasje të barabartë dhe në kohë në shërbimet shëndetësore, në pajtim me arrijtjet më të reja shkencore.

Kërkojmë përgjegjësi për rastet e vdekjes për shkak të vendimeve që nuk merren në kohë për mjekim jashtë shtetit.

Kemi të drejtë për standard më të lartë për mbrojtje shëndetësore, pa marrë parasysh se ku jetojmë.

Mjaft më prej mbrojtjes shëndetësore jocilesore dhe nga barna dhe terapi të lira dhe joefikase.

Mjaft më shkelje të të drejtave të pacientëve të cilët askush nuk i sanksionon.

Kërkojmë kushte më të mira për mjekim në institucionet shëndetësore, rritje e pagave të punëtorëve shëndetësorë dhe përmirësim i kushteve të tyre të punës.

Kërkojmë respektim të të drejtave të pacientëve nga ana e punëtorëve shëndetësorë dhe mbrojtje të të drejtave nga ana e institucioneve kompetente.



Kushtetuta e RM



„Çdo qytetarit i garantohet e drejta për mbrojtje shëndetësore. Qytetari ka të drejtë dhe obligim të ruajë dhe përparojë shëndetin e vetë dhe të tjerëve.“

Burokracia merr jetë

„Qytetarët përsëri ballafaqohen me procedura të gjata për të marrë vendim për mjekim jashtë shtetit...“ (Raport i Avokatit të popullit për vitin 2014)

Papërgjegjësia e tyre, sëmundja jonë

„Qytetarët vite me radhë presin zgjidhjen e rasteve të tyre, për shkak të veprimit joefikas dhe jo në kohë sipas kërkesave të tyre nga ana e Fondit për Sigurim Shëndetësor dhe Ministria e Shëndetësisë.“ (Raport i Avokatit të popullit për vitin 2014)

Mjaft më padrejtësi sociale!

„Republika kujdeset për mbrojtjen sociale dhe sigurinë sociale në pajtim me parimin për drejtësi sociale. Republika u garanton të drejtë për ndihmë për qytetarët të pafuqishëm dhe të paaftë për punë.“ (Kushtetuta e RM)

Mjaft më me ndihmë mizore sociale financiare, e cila nuk mbulon as gjysmën e mjeteve të nevojshme për të ushqyer një familje me katër anëtarë.


Ndihma sociale financiare për familje dhe amvisëri me katër anëtarë ka qenë vetëm 5.173 denarë më vitin 2014.

Kërkojmë rritje të ndihmës sociale financiare dhe pagesë të kohëshme.

Stop për shtypjet burokratike, kërcënimet dhe fshirjen nga evidenca e personave të papunësuar.

Më të cenuarit pa mbrojtje

Avokati i popullit konstatoi: „Mbrojtja sociale e qytetarëve kryhet me pengesa, kurse për shkak të pagesës së vonshme të mjeteve financiare, qytetarët ballafaqohen me pengesa në jetën e përditshme.“



Tirani burokratike!

Si rezultat i shkeljes së kushtetutës, më prill të vitit 2013 mbi 120 mijë të papunësuar kanë mbetur pa sigurim shëndetësor. NOVA TV

Kushtetuta e RM



“Vlera themelore të renditjes kushtetuese të Republikës së Maqedonisë janë: humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti“

Botues: Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni

Për botuesin: Fani Karanfilova – Panovska

Dizajni artistik-grafik: Koma

Vulë: Serafimovski

*pajisja e titujve dhe teksteve është e Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni